



REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Det. DPKI
 Dep. DPKI
 Nr. i faq. 02
 Broj stranica 02
 Nr. pages 02

Pr. No. 03-02/2953/16
 Date 20.10.2016
 PRISTINE

Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
 ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 19.10.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2953/16, për z. Gjevdet Metaj, Anëtar i Kuvendit Komunal në Istog, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Gjevdet Metaj, Anëtar i Kuvendit Komunal në Istog, dhe njëkohësisht pronar dhe person i autorizuar në biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese, kemi organizuar një takim me zyrtarin e lartë në Agjencinë kundër Korrupsionit. Gjatë këtij takimi z. Metaj është njoftuar me fakte për gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhet dhe për ndryshimet që duhet ti bëjë për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë, ka pranuar rekomandimin e Agjencisë për tu larguar nga funksioni menaxherial në biznes privat, për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, zyrtari i lartë ka dërguar në Agjenci një shkresë zyrtare (DPKI.03-02/3638/16) me të cilën vërtetohet se zyrtari i lartë është larguar nga funksioni menaxherial në biznesin privat N.P.T “Besa Petrol”.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit